

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur, i themeluar për të administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë dhe me plotësimet e mëtutjeshme të këtij ligji. FKPK-ja, në përputhje me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, e rishpall këtë:

KONKURS PUBLIK

për angazhimin me kontratë për punë dhe detyra specifike sikurse në vijim:

Titulli i pozitës:	PRODUCENT I MULTI-MEDIAS
Orët e punës:	Jo më shumë se 120 ditë në vit (kryesisht punë në distancë)
Numri i referencës:	R-KON092025
Kohëzgjatja e emërimit:	Kontratë për punë dhe detyra specifike
Adresa e institucionit:	Rr. "Perandori Justinian" Nr. 71, 10000 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë e producentit:

- Të ndihmojë në projektimin e fushatave vetëdijësuese dhe informuese.
- Të prodhojë video me përmbajtje multi-mediale, sipas nevojave të FKPK-së.
- Të bashkëpunojë (kur ka nevojë) me palë të treta për të realizuar projekte të prodhimit multi-medial.
- Të jetë i përpiktë në realizimin e kërkesave nga FKPK-ja.

Kriteret e konkursit:

Arsimimi:	• Diploma e arsimit të lartë universitar në fushën e regjisë ose arteve është përparësi.
	• Të ketë së paku tri vjet përvojë në prodhimin e reklamave dhe produkteve të tjera të ngjashme multimediale. • Të ketë qenë producent në së paku pesë prodhime të video-reklamave.
Përvoja:	• Producenti i multi-medias duhet të ketë përvojë të dëshmuar në: a) xhirim, b) montazh, c) animacione grafike (2D dhe 3D), d) aftësi të menaxhimit të projekteve, e) udhëheqje e procesit të prodhimit (nga fillimi deri në finalizim) dhe f) kapacitete të larta organizative me palët e nevojshme për produktet multimediale.
Dëshmi:	• Të gjitha deklaratimet për arsimimin, certifikimet dhe përvojën e punës do të duhet të dëshmohen dhe konfirmohen para nënshkrimit të kontratës me kandidatin e përzgjedhur.

Mënyra e vlerësimit:

- Komisioni Vlerësues do t'i vlerësojë kandidatët sipas: përvojës profesionale, portofolit, arsimimit (diplomave dhe certifikatave) paraqitjes në intervistë dhe ofertës financiare.

Afati dhe mënyra e konkurrimit:

- Konkursi është i hapur për periudhën: **9 shkurt deri më 23 shkurt 2026 në ora 16:00 (CET).**
- Aplikimi bëhet vetëm përmes email-it në adresën: **recruitment@trusti.org**, me referencë: **"Producent i multi-medias"**.
- Emailit për aplikim duhet t'i bashkëlidhen dokumentet në vijim: 1) Biografia (CV-ja); 2) Letërmotivimi, 3) Dëshmitë e shkollimit dhe certifikimeve (nëse ka) dhe 4) Certifikata e historisë penale.

Vërejtje: Aplikacionet pa dokumentet e lartcekura të bashkangjitura, ose që nuk janë në formatin e kërkuar, NUK do të shqyrtohen. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet do të kontaktohen.

FKPK-ja është punëdhënëse që ofron mundësi të barabarta për të gjithë!